



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVESH KOLLA E MESME
PROFESIONALE "THOMAS PAPAPANO" GJIROKASTËR

Nr. 150/prot.

Gjirokastrë më: 16.09.2024

Lënda : Njoftim për levizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 "Për ndajjen e Punësimit", Ligjit nr. 15/2017 "Për Arsimit dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore", Përbërjes së Njësisë së Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional", të Udhëzimit nr. 25, datë 01/09/2023 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mesimore në Ofruesit e Arsimit Profesional".

Shkolla e mesme profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastrë ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin :

1. Mësues i Teorisë dhe Praktikës Profesionale, drejtimi Hoteleri Turizëm, me kohë të pjesëshme.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për levizjen paralele si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit

f) të demonstrojë aftësitë punës në grup dhe meftisimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.

b) të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) Letër-motivimin për pozicionin;

b) Jetëshkrimin (CV-në sipas shtojcës 11 të udhëzimit 14 dt. 27.05.2021),

c) Kartën e identitetit;

d) Diplomen;

e) Librezën e punës;

f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g) Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;

i) Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;

j) Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

l) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

m) Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara;

n) Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, 23 09 2024

DREJTOR
Renata Puleri

